



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 608/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.09.2018, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Vëllezrit Agalliu /M, në procedurën e prokurimit “*Kërkesë për Propozime*” me Nr. REF-73675-06-06-2018, me objekt : “*Blerje vegla pune*”, me fond limit 2 016 338 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 29.06.2018 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Ujësjetllës Kanalizime Vlorë.

Ankimues: “Zihni Muçaj” p.f.
Adresa: Rruga “Gjergj Kastrioti”, Pallati “3 Kullat”, Vlorë.

Autoriteti Kontraktor: Sh.A Ujësjetllës Kanalizime Vlorë
Adresa: Lagja “Kushtrimi” Rr. Arkobaleno Vlorë

Subjekte të interesuar: “Vëllezrit Agalliu /M,
Adresa: Rruga Nacionale Vlore Fier, Godina e Vëllezërve Agalliu, Skrofotinë, Novoselë, Vlorë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010 “*Për*

miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 13.06.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me Nr. REF-73675-06-06-2018, me objekt : “Blerje vegla pune”, me fond limit 2 016 338 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 29.06.2018 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Ujësjellës Kanalizime Vlorë.

II.2. Në datën 29.06.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

Referuar informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor, në këtë procedurë prokurimi, kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

- | | |
|-----------------------------------|-----------------------------|
| 1. “Ekspo Sistem” sh.p.k. | pa ofertë ekonomike |
| 2. “Vëllezrit Agalliu /M” sh.p.k. | 1,249,900 lekë kualifikuar |
| 3. “Zihni Muçaj” p.f. | 1,590,000 lekë kualifikuar |
| 4. “Alfat” sh.p.k. | 1,661,473 lekë kualifikuar |
| 5. “Muça” sh.p.k. | 1,728,745 lekë skualifikuar |

6.	“Ligus” sh.p.k.	1,785,230 lekë kualifikuar
7.	“Bolt” s.p.k.	1,806,560 lekë kualifikuar
8.	“Asi -2A CO” sh.p.k.	1,877,000 lekë kualifikuar
9.	“Vasaa” sh.p.k.	1,887,770 lekë kualifikuar
10.	“Mega Plast -2L” sh.p.k.	1,986,850 lekë kualifikuar

II.3. Në datën 29.06.2018 operatori ekonomik “Zihni Muçaj” p.f.është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe kualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

II.4. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor, si edhe dokumentacionit shoqëruar ankesës së operatorit ekonomik të depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në datën 03.07.2018, operatori ekonomik ankimues “Zihni Muçaj” p.f.ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Vëllezrit Agalliu /M” sh.p.k., duke argumentuar si më poshtë vijon:

[...]Kualifikimi i padrejtë dhe i paligjshëm i oe-së “Vëllezrit Agalliu /M” sh.p.k., për procedurën e mësipërme të prokurimit në kundërshtim me kriteret e kualifikimit të parashikura në dokumentat e tenderit dhe LPP-së. Për procedurën e konkurimit publik të tenderit të mësipërm autoriteti juaj në datën 24.06.2018 tek rubrika “kërkesat” keni dërguar mesazhin me subjekt “Kërkesë për argumentimin e ofertës ekonomike” me përmbajtje si më poshtë vijon:

Në tenderin me objekt “Blerje vegla pune” për nevojat e SH.A Ujësjetës Kanalizime Vlorë, oferta e dhënë nga oe-ja rezulton anomalisht e ulët . Lutemi të bëni argumentimin e ofertë tuaj në bazë të nenit 56 të lpp-së brenda 3 ditëve pune nga dita e marrjes së njoftimit. Mosparaqitja e argumentimit con në skualifikimin e ofertës tuaj. Ju faleminderit.

Më pas në datën 27.06.2018 ka ardhur përgjigje nga oe-ja “Vëllezrit Agalliu /M” sh.p.k për argumentimin e ofertës anomalisht të ulët me përmbajtjen si më poshtë:

“Oferta jonë është e tillë sepse ne si oe dhe si kompani në radhë të parë jemi një ndër importuesit më të mëdhenj në Shqipëri të veglave të punës dhe gjithashtu punojmë me marzh të ulët në krahasim me konkurentët tanë. Të gjithë artikujt e veglave të punës ne i shpërndajmë me cmime shumice dhe jemi distributor i kompanive respektive për tregun shqiptar”

Ju na informuat më datë 29.06.2018 ora 14:33 renditjen dhe vlerësimin e ofertave për tenderin e mësipërm.

[...]

Nga renditja dhe vlerësimi i ofertave të bëra rezulton se Ak-ja ka kualifikuar operatorin ekonomik “Vëllezrit Agalliu /M” sh.p.k. në mënyrë të jashtëligjshme dhe në kundërshtim me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentat e tenderit dhe LPP-në për këtë procedurë.

Operatori ekonomik “Vëllezrit Agalliu /M” sh.p.k. nuk ka mundur dot të vërtetojë dhe argumentojë ofertën ekonomike anomalisht të ulët. Bazuar në nenin 56 të LPP-së dhe e referojmë atë[...]

Kualifikimi i oe-së “Vëllezrit Agalliu /M” sh.p.k është bërë në kundërshtim me nenin 56 të LPP-së . Oferta e këtij oe-je në vlerën 1,249,900 lekë është anomalisht e ulët. Nga përgjigjia e dhënë e sqërisë në argumentimin e ofertës anaomalisht të ulët në asnjë rast nuk ka sqaruar me dokumenta dhe fakte se oplotëson të gjitha parashikimet nenit 56 të LPP-së. Operatori ekonomik “Vëllezrit Agalliu /M” sh.p.k.ka sqaruar në mënyrë narrative dhe pa u mbështetur në prova dhe fakte bindëse për argumentimin

e ofertës dhe për të qënë bindëse se oe-ja mund të përmbushë me sukses realizimin e kontratës në rast të shpalljes fitues për këtë procedurë prokuruese.

Konkretisht shoqëria nuk ka vërtetuar me dokumenta bindëse provuese mbi cmimin për ofertimin e materialeve cilësore për realizimin e kontratës së furnizimit për procedurë prokuruese “Blerje vegla pune”. Nuk ka dorëzuar asnjë kontratë furnizimi apo fatura me cmime që justifikojnë ofertën e dorëzuar nga shoqëria “Vëllezrit Agalliu /M” sh.p.k.

Së dyti nuk ka vërtetuar se ka ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për kryerjen e furnizimit të mallrave objekt prokurimi.

Së treti shoqëria nuk ka plotësuar kushtin e nenit 56 të LPP-së pasi në asnjë rast nuk ka vërtetuar orgjinalitetin e punëve mallrave të propozuara. Së katërti nuk ka mundur të provojë zbatueshmërinë e detyrimeve që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo do të sigurohet furnizimi.

Në cdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementët e vecantë të ofertës në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP-së.

Nga interpretimi literal i nenit 56 pika 1 e LPP-së , si dhe vendimet e ngjashme të Kpp-së referojmë vendimin nr. 518/2016 konstatohet se barra e provës mbi argumentimin e ofertës anomalisht të ulët i përket oe-së oferta e të cit është konstatuar nga KVO-ja dhe në zbatim të VKM-së nr. 914/2014. Argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë 4 kushte kumulative për ti dhënë garanci si dhe bindje autoritetit kontraktor. Së pari operatori ekonomik sipas të cilit oferta rezulton anomalisht e ulët duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose shërbimeve të ofruara. Së dyti operatori ekonomik duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të ofruara si edhe në raste të vecanta dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve për furnizimin e mallrave apo shërbimeve. Së treti operatori ekonomik oferta e të cilit është konsideruar anomalisht e ulët duhet të paraqesë prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me orgjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi. Së katërti operatori ekonomik ankimes duhet të vërtetojë zbatueshmërinë e detyrimeve që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo furnizimi. Gjykojmë se argumenti i i operatorit ekonomik “Vëllezrit Agalliu /M” sh.p.k. në mbështetje të ofertës së paraqitur në procedurën e prokurimit rezulton se ky i fundit nuk është konform kërkesave të përcaktuara në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Konstatojmë se operatori ekonomik “Vëllezrit Agalliu /M” sh.p.k. nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion mbështetës ose provues të argumentojë kushtet apo elementët e favorshëm pse kjo ofertë e dalë anomalisht e ulët duhet të pranohet dhe se nuk krijon asnjë rrezik për mosrealizimin me sukses të kontratës.

Përsa kemi argumentuar më sipër për ofertën e operatorit ekonomik “Vëllezrit Agalliu /M” sh.p.k. për procedurën prokuruese “Blerje vegla Pune” nuk ka asnjë bazë ligjore dhe është në kundërshtim me kriteret e kualifikimit të përcaktura në dst për procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me LPP-në konkretisht nenin 56 pika 1 dhe 2.

Bazuar në LPP-në parashikohet se : Kualifikimi i operatorëve ekonomikë bëhet kur vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet nevojshme teknike për të zbatuar kontratën. Përsa u përmet më sipër operatori ekonomik “Vëllezrit Agalliu /M” sh.p.k. nuk ka mundur dot të vërtetojë dhe argumentojë ofertën ekonomike anomalisht të ulët. Bazuar në nenin 56 të LPP-së.

Përsa më sipër kërkojmë anulimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të datës 29.06.2018 dhe skualifikimin e operatorit ekonomik “Vëllezrit Agalliu /M” sh.p.k. për procedurën prokuruese me objekt “Blerje vegla pune”.

Në rast se ankesa jonë nuk merret parasysh, në bazë të LPP-së do të drejtohem me formularin përkatës të ankesës Autoritetit të KPP-së sipas afateve të përcaktura në ligj.

II.5. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor, të depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor nëpërmjet shkresës me nr. 826prot., datë 05.07.2018 i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimes në lidhje me ankesën e paraqitur nga ky i fundit pranë autoritetit kontraktor.

Konkretisht autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes (vendim nr. 823prot., datë 05.07.2018) argumenton si më poshtë vijon:

[...]

Pas pezullimit të procedurës së prokurimit në cilësinë e anëtarëve të komisionit të shqyrtimit të ankesave na është ngarkuar shqyrtimi i formularit të ankimit nr. 575prot., datë 03.07.2018 paraqitur pranë autoritetit kontraktor nga operatori ekonomik “Zihni Muçaj” p.f. me aktivitet në Vlorë. Sa më lart, pasi lexuam ankesën në fjalë dhe pasi na vunë në dispozicion dokumentacionin e duhur njësia e prokurimit analizojmë se:

Nga ana formale dhe procedurale, formulari i ankiit është plotësuar dhe paraqitur brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 63 pika 1.1 e në vijim të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe nenit 78 pika 4 e në vijim të VKM-së RrPP-së. Në rubrikën “Deklaratë e hollësishme e fakteve dhe argumentave” ju pretendoni:

Nga renditja dhe vlerësimi i ofertave të bëra rezulton se autoriteti juaj ka kualifikuar operatorin ekonomik “Vëllezrit Agalliu /M” sh.p.k. në mënyrë të jashtëlgjshme dhe në kundërshtim me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentat standarte të tenderit dhe LPP-në, për procedurën prokuruese “Blerje vegla pune” të zhvilluar nga autoriteti juaj. Operatori ekonomik nuk ka mundur të vërtetojë dhe argumentojë ofertën ekonomike anomalisht të ulët.

Bazuar në të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion nga njësia e prokurimit dhe KVO, si dhe provat shkresore të paraqitura me kërkesën tonë, nga operatori ekonomik “Vëllezrit Agalliu /M” sh.p.k. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vendoi:

Mospranimin e ankimit të operatorit ekonomik “Zihni Muçaj” p.f. pasi operatori ekonomik Vëllezrit Agalliu /M” sh.p.k. përmbush kriteret e përcaktuara në dokumentat standart të tenderit, në përputhje me LPP-në, si dhe ka argumentuar me prova shkresore vlerën anomalisht të ulët qëka ofruar.[...]

II.6. Në datën 16.07.2018, operatori ekonomik ankimes ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke ngritur të njëjtat pretendime si edhe në ankesën e depozituar pranë autoritetit kontraktor.

II.7. Në datën 30.07.2018, nëpërmjet shkresës me nr.939prot., datë 26.07.2018, protokolluar me tonën nr. 1262/2prot datë 30.07.2018 prot., me objekt: “Përcjellje informacioni”, si dhe shkresa nr. 1071prot datë 10.09.2018, protokolluar me tonën 1262prot.datë 12.09.2018, me objekt “Përcjellje informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Muça” sh.p.k.

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Zihni Muçaj” p.f., mbi kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Vëllezrit Agalliu /M” sh.p.k., në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin : “[...]Kualifikimi i padrejtë dhe i paligjshëm i oe-së “Vëllezrit Agalliu /M” sh.p.k., për procedurën e mësipërme të prokurimit në kundështim me kriteret e kualifikimit të parashikura në dokumentat e tenderit dhe LPP-së. Për procedurën e konkurimit publik të tenderit të mësipërm autoriteti juaj në datën 24.06.2018 tek rubrika “kërkesat” keni dërguar mesazhin me subjekt “Kërkesë për argumentimin e ofertës ekonomike” me përmbajtje si më poshtë vijon:

Në tenderin me objekt “Blerje vegla pune” për nevojat e SH.A Ujësjetës Kanalizime Vlorë, oferta e dhënë nga oe-ja rezulton anomalisht e ulët . Lutemi të bëni argumentimin e ofertë tuaj në bazë të nenit 56 të lpp-së brenda 3 ditëve pune nga dita e marrjes së njoftimit. Mosparaqitja e argumentimit con në skualifikimin e ofertës tuaj. Ju faleminderit.

Më pas në datën 27.06.2018 ka ardhur përgjigje nga oe-ja “Vëllezrit Agalliu /M” sh.p.k për argumentimin e ofertës anomalisht të ulët me përmbajtjen si më poshtë:

“Oferta jonë është e tillë sepse ne si oe dhe si kompani në radhë të parë jemi një ndër importuesit më të mëdhenj në Shqipëri të veglave të punës dhe gjithashtu punojmë me marzh të ulët në krahasim me konkurentët tanë. Të gjithë artikujt e veglave të punës ne i shpërndajmë me cmime shumice dhe jemi distributor i kompanive respektive për tregun shqiptar”

Ju na informuat më datë 29.06.2018 ora 14:33 renditjen dhe vlerësimin e ofertave për tenderin e mësipërm.

[...]

Nga renditja dhe vlerësimi i ofertave të bëra rezulton se Ak-ja ka kualifikuar operatorin ekonomik “Vëllezrit Agalliu /M” sh.p.k. në mënyrë të jashtëligjshme dhe në kundështim me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentat e tenderit dhe LPP-në për këtë procedurë.

Operatori ekonomik “Vëllezrit Agalliu /M” sh.p.k. nuk ka mundur dot të vërtetojë dhe argumentojë ofertën ekonomike anomalisht të ulët. Bazuar në nenin 56 të LPP-së dhe e referojmë atë[...]

Kualifikimi i oe-së “Vëllezrit Agalliu /M” sh.p.k është bërë në kundështim me nenin 56 të LPP-së . Oferta e këtij oe-je në vlerën 1,249,900 lekë është anomalisht e ulët. Nga përgjigjia e dhënë e sqërisë në argumentimin e ofertës anaomalisht të ulët në asnjë rast nuk ka sqaruar me dokumenta dhe fakte se oplotëson të gjitha parashikimet nenit 56 të LPP-së. Operatori ekonomik “Vëllezrit Agalliu /M” sh.p.kka sqaruar në mënyrë narrative dhe pa u mbështetur në prova dhe fakte bindëse për argumentimin e ofertës dhe për të qënë bindëse se oe-ja mund të përmbushë me sukses realizimin e kontratës në rast të shpalljes fitues për këtë procedurë prokuruese.

Konkretisht shoqëria nuk ka vërtetuar me dokumenta bindëse provuese mbi cmimin për ofertimin e materialeve cilësore për realizimin e kontratës së furnizimit për procedurë prokuruese “Blerje vegla

pune”. Nuk ka dorëzuar asnjë kontratë furnizimi apo fatura me cmime që justifikojnë ofertën e dorëzuar nga shoqëria “Vëllezrit Agalliu /M” sh.p.k.

Së dyti nuk ka vërtetuar se ka ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për kryerjen e furnizimit të mallrave objekt prokurimi.

Së treti shoqëria nuk ka plotësuar kushtin e nenit 56 të LPP-së pasi në asnjë rast nuk ka vërtetuar origjinalitetin e punëve mallrave të propozuara. Së katërti nuk ka mundur të provojë zbatueshmërinë e detyrimeve që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo do të sigurohet furnizimi.

Në cdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementët e vecantë të ofertës në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP-së.

Nga interpretimi literal i nenit 56 pika 1 e LPP-së , si dhe vendimet e ngjashme të Kpp-së referojmë vendimin nr. 518/2016 konstatohet se barra e provës mbi argumentimin e ofertës anomalisht të ulët i përket oe-së oferta e të cit është konstatuar nga KVO-ja dhe në zbatim të VKM-së nr. 914/2014. Argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë 4 kushte kumulative për ti dhënë garanci si dhe bindje autoritetit kontraktor. Së pari operatori ekonomik sipas të cilit oferta rezulton anomalisht e ulët duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose shërbimeve të ofruara. Së dyti operatori ekonomik duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të ofruara si edhe në raste të vecanta dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve për furnizimin e mallrave apo shërbimeve. Së treti operatori ekonomik oferta e të cilit është konsideruar anomalisht e ulët duhet të paraqesë prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi. Së katërti operatori ekonomik ankimes duhet të vërtetojë zbatueshmërinë e detyrimeve që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo furnizimi. Gjykojmë se argumenti i i operatorit ekonomik “Vëllezrit Agalliu /M” sh.p.k. në mbështetje të ofertës së paraqitur në procedurën e prokurimit rezulton se ky i fundit nuk është konform kërkesave të përcaktuara në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Konstatojmë se operatori ekonomik “Vëllezrit Agalliu /M” sh.p.k. nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion mbështetës ose provues të argumentojë kushtet apo elementët e favorshëm pse kjo ofertë e dalë anomalisht e ulët duhet të pranohet dhe se nuk krijon asnjë rrezik për mosrealizimin me sukses të kontratës.

Përsa kemi argumentuar më sipër për ofertën e operatorit ekonomik “Vëllezrit Agalliu /M” sh.p.k. për procedurën prokuruese “Blerje vegla Pune” nuk ka asnjë bazë ligjore dhe është në kundërshtim me kriteret e kualifikimit të përcaktura në dst për procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me LPP-në konkretisht nenin 56 pika 1 dhe 2.

Bazuar në LPP-në parashikohet se : Kualifikimi i operatorëve ekonomikë bëhet kur vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet nevojshme teknike për të zbatuar kontratën. Përsa u përmet më sipër operatori ekonomik “Vëllezrit Agalliu /M” sh.p.k. nuk ka mundur dot të vërtetojë dhe argumentojë ofertën ekonomike anomalisht të ulët. Bazuar në nenin 56 të LPP-së.

Përsa më sipër kërkojmë anulimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të datës 29.06.2018 dhe skualifikimin e operatorit ekonomik “Vëllezrit Agalliu /M” sh.p.k. për procedurën prokuruese me objekt “Blerje vegla pune”.

Në rast se ankesa jonë nuk merret parasysh , në bazë të LPP-së do ti drejtohem me formularin përkatës të ankesës Autoritetit të KPP-së sipas afateve të përcaktura në ligj.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Nga shqyrtimi i informacionit të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik nga ana e autoritetit kontraktor me anë të shkresës nr.939 protokolli datë 26.07.2018 protokolluar pranë K.P.P. nr.1262/2 protokolli datë 30.07.2018 rezulton se, në datën 27.06.2018 përmes një mesazhi në faqen e APP- së autoriteti kontraktor i ka kërkuar shpjegime operatorit ekonomik “Vëllezrit Agalliu /M” sh.p.k. mbi argumentimin e ofertës anomalisht të ulët konkretisht citoj: “[...] Në tenderin me objekt “Blerje vegla pune” për nevojat e sh.a Ujësjetës Kanalizime Vlorë” oferta e dhënë nga operatori juaj ekonomik rezulton anomalisht e ulët. Lutemi bëni argumentimin e ofertës tuaj në bazë të nenit 56 të LPP-së brenda 3 ditëve pune nga data e marrjes së njoftimit.Mosparqitja e e një argumentimi con në skualifikimin e ofertës tuaj[...]

III.1.2. Nga shqyrtimi i informacionit të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik nga ana e autoritetit kontraktor me anë të shkresës nr.939 protokolli datë 26.07.2018 protokolluar pranë K.P.P. nr.1262/2 protokolli datë 30.07.2018, si dhe shkresës nr. 1071prot datë 10.09.2018, protokolluar me tonën 1262/3 prot. datë 12.09.2018, rezulton se në datën 27.06.2018 operatori ekonomik “Vëllezrit Agalliu /M” sh.p.k. përmes një mesazhi në faqen e APP- së i është përgjigjur autoritetit kontraktor citojmë: “[...]Oferta jonë është e tillë sepse ne si operator ekonomik dhe si kompani në radhë të parë jemi në ndër importuesit më të mëdhenj në shqipëri të veglave të punës dhe gjithashtu punojmë me marzh të ulët në krahasim me konkurrentët tanë. Të gjithë artikujt e veglave të punës ne i shpërndajmë me cmime shumice dhe jemi distribuitor i kompanive respektive [për tregun shqiptar[...]

III.1.3. Në datën 29.06.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit. Referuar informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor, në këtë procedurë prokurimi, kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

1.	”Ekspo Sistem” sh.p.k.	pa ofertë ekonomike
2.	“Vëllezrit Agalliu /M” sh.p.k.	1,249,900 lekë kualifikuar
3.	“Zihni Muçaj” p.f.	1,590,000 lekë kualifikuar
4.	“Alfat” sh.p.k.	1,661,473 lekë kualifikuar
5.	“Muça” sh.p.k.	1,728,745 lekë skualifikuar
6.	“Ligus” sh.p.k.	1,785,230 lekë kualifikuar
7.	“Bolt” sh.p.k.	1,806,560 lekë kualifikuar
8.	“Asi -2A CO” sh.p.k.	1,877,000 lekë kualifikuar
9.	“Vasaa” sh.p.k.	1,887,770 lekë kualifikuar
10.	“Mega Plast -2L” sh.p.k.	1,986,850 lekë kualifikuar

III.1.4. Në nenin 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon se “[...]

1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo

shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me 8 procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për: a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara; b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve; c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi; ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj [...].”

III.1.5. Në nenin 66 pika 5 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikon se “ Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: - Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur. Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP. [...]”

III.1.6. Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “Vëllezrit Agalliu /M” sh.p.k. si edhe nga përlllogaritjet e kryera Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se oferta ekonomike në vlerën prej 1,249,900 lekë pa TVSH, në zbatim të nenit 66 pika 5 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave për “Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, rezulton anomalisht e ulët. Sa më sipër, K.P.P. gjykon se autoriteti kontraktor ka vepruar drejt kur gjatë periudhës së vlerësimit të ofertave i ka kërkuar informacion të detajuar operatorit ekonomik “Vëllezrit Agalliu /M” sh.p.k. në zbatim të nenit 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar

III.1.7. Nga interpretimi literal i nenit 56 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe në zbatim të VKM 914/2014. Gjithashtu, K.P.P. gjykon se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor. Së pari, operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të ofruara si edhe në raste të veçanta dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve,

për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi, si edhe së fundmi duhet të vërtetojë zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. K.P.P. gjykon se katër kushtet e mësipërme të parashikuara nga lex specialis janë kushte kumulative të cilat më anë të provave shkresore dhe argumentimeve përkatëse duhen plotësuar nga operatorët ekonomikë ankimues, oferta e të cilëve rezulton anomalisht e ulët. Referuar nenit 56 pika 2 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elementë duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. K.P.P. gjykon se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangijen e riksut që mund të sjellë një ofertë e cila rezulton anomalisht e ulët. K.P.P. gjykon se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime ku ndër të tjera si: rreziku për mos kryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kosto që i lindin autoritetit nga mos kryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga mos kryerja e shërbimit gjatë periudhës së ri publikimit të procedurës së tenderit në rast të mos zbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, K.P.P. thekson se referuar nenit 1 gërma “b” “Objekti dhe qëllimi” i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës që mund të vijë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përllogaritjes të parashikuar në ligj.

II.1.6. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Vëllezrit Agalliu /M” sh.p.k. në mbështetje të ofertës së paraqitur në procedurën e mësipërme të prokurimit, rezulton se ky i fundit nuk është konform kërkesave të përcaktuara në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik “Vëllezrit Agalliu /M” sh.p.k. nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion mbështetës ose provues si: fatura tatimore, fletë zhdoganimi, kontrata furnizimi, kontrata të mëparshme të lidhura me autoritete të ndryshme, apo ndonjë dokument tjetër, që të argumentojë kushtet apo elementët e favorshëm pse kjo ofertë e dalë anomalisht e ulët duhet të pranohet dhe se nuk krijon asnjë rrezik për mosrealizimin me sukses të kontratës. Akoma edhe më tej, referuar shkresës datë 1071prot. datë 10.09.2018 protokolluar me tonën 1262/3prot datë 12.09.2018 të autoritetit kontraktor përcjellë pranë KPP-së rezulton se, është paraqitur vërtetim (për xhiron e tre viteve të fundit) nr. T00352689 datë 12.06.2018 i subjektit “Vëllezrit Agalliu /M” sh.p.k. dhe një kontratë distribucioni nr. 10208/1705/14.12.2017 e cila në përmbajtje është një marrëveshje paraprake me prodhuesit pa cmime që do ofertojmë për këto materiale ndërkohë që nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për të vërtetuar këtë fakt. Në këtë kuptim Komisioni i Prokurimit Publik vëren se shoqëria “Vëllezrit Agalliu /M” sh.p.k., përveç argumentimit të vet në formën e një mesazhi vetdeklarativ, dhe një kontratë distribucioni nuk ka paraqitur prova shkresore për elementet e ofertës sikurse kërkuar, as në autoritetin kontraktor dhe as në

KPP. Operatori ekonomik ankimues ka detyrimin ligjor që të prezantojë me dokumentacion provues zgjidhjet teknike dhe/ose ndonjë kusht favorizues që do të garantonin furnizimin e mallrave pranë autoritetit kontraktor. Nga vlerësimi i dokumentacionit të administruar, nga ana e ofertuesit nuk rezulton të jenë parashtruar të dhëna, fakte apo garanci për origjinalitetin e mallrave në referim të gërmës ç, neni 56 pika 2, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pasi provueshmeria e këtij kriteri është esenciale duke garantuar autoritetin kontraktor jo vetëm për furnizimin e mallrave, por edhe mallrat e ofruar prej tyre të jenë sipas standarteve të kërkuara në cilësi dhe volum dhe me çmimin konkurues të ofertuar. Bazuar në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara më lart, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e operatorit ekonomik – oferta e të cilit në zbatim të formulës të përcaktuar në legjislacion ka dalë anomalisht e ulët, janë paraqitur sqarime vetëm nëpërmjet një mesazhi elektronik në faqen e APP-së jo i plotë që të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët (në kuptim të: metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, kushte përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinaliteti i punës së propozuar), duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Zihni Muçaj” p.f. për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me Nr. REF-73675-06-06-2018, me objekt : “Blerje vegla pune”, me fond limit 2 016 338 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 29.06.2018 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Ujësjetllës Kanalizime Vlorë.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik “Vëllezrit Agalliu /M” sh.p.k duke e skualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Zihni Muçaj” p.f.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.1262 Protokolli, Datë 16.07.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha